



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:152485
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05613574

K.DH.SH.II.nr.208/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “New Corp” L.L.C, me seli ne fshatin Miradi e Ulët Fushë Kosovë, me numër identifikues 811253301 përfaqësuar nga pronari B.B., ndaj debitorit “DORO FIX” shpk, me seli ne Gllogoc, fshati Sankoc, me numër unik identifikues 811168146, përfaqësuar nga pronari D.O., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditori e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.356/23 dt.30.11.2023, me datën 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit “New Corp” L.L.C, me seli ne fshatin Miradi e Ulët Fushë Kosovë, me numër identifikues 811253301 përfaqësuar nga pronari B.B., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkallës se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.356/23 dt.30.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.356/23 dt.30.11.2023, ka aprovuar ne tërësi prapësimin e debitorit “DORO FIX” shpk, me seli ne Gllogoc, fshati Sankoc, me numër unik identifikues 811168146, përfaqësuar nga pronari D.O., ndërsa anulon urdhrin përmbarimor P.nr.567/22 dt.07.07.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferri Prishtinë si dhe ka përfunduar procedurën ne këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar të dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta miratojë në tërësi si të bazuar këtë ankesë dhe aktvendimin e atakuar ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje në shkallë të parë.

Përgjigje ndaj ankesës së kreditorit ka ushtruar debitori dhe propozon që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori "New Corp" L.L.C, me seli në fshatin Miradi e Ulët Fushë Kosovë, me numër identifikues 811253301 përfaqësuar nga pronari B.B., me datë 06.07.2022 ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit "DORO FIX" shpk, me seli në Glllogoc, fshati Sankoc, me numër unik identifikues 811168146, përfaqësuar nga pronari D.O., në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.AB-22-0008 dt.09.02.2022. Përmbaremore privat Isa Gacaferi Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr.567/22 dt.07.07.2022, ka lejuar përmbaremore me të cilin ka obliguar debitorin që në emër të borxhit nga fatura, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 3,300.00 euro.

Ndaj urdhrin përmbaremore, me datën 20.07.2022, debitori ka ushtruar prapësim, përmes së cilit deklaron se borxhin e ka paguar para se ta marrë propozimin për përmbaremore përkatësisht me datën 08.07.2022 ndërsa propozimin e ka pranuar me datën 11.07.2022 dhe për këtë e ka njoftuar përmbaremoren privat ndërsa si dëshmi sjell fletëpagesën, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbaremore ta shfuqizojë sa i përket shpenzimeve procedurale.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 22.07.2022, me arsyetimin se i kanë bërë thirrje shumë here për pagesë të detyrimit, shton se kemi hapur rastin me datën 06.07.2022 ndërsa debitori ka bërë pagesën me datën 08.07.2022 por nuk i ka paguar shpenzimet e procedurës në vlerë prej 100.65 euro dhe kamatëvonesën.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.356/23 dt.30.11.2023, me të cilin ka vendosur të aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbaremore ta anulojë dhe ta përfundojë procedurën përmbaremore në këtë çështje, duke vendosur definitivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Arsyeton se nga emaili i datës 15.07.2022 që është pjesë e shkresave të lëndës rezulton se Përmbaremore Privat i kishte kërkuar debitorit pagesën e shpenzimeve procedurale me arsyetimin se borxhi ishte paguar pas inicimit të procedurës përmbaremore e në përputhje me UA për Tarifa, debitori obligohet të përmbushë edhe shpenzimet e procedurës dhe në të njëjtën

komunikatë i kishte bashkëngjitur edhe faturën dhe shpenzimet e procedurës përbarimore. Gjykata ka gjetur si të bazuara pretendimet e debitorit se nuk është i detyruar të paguaj shpenzimet procedurale pasi i kishte përmbushur borxhin para fillimit të procedurës përbarimore ndërsa urdhrin përbarimor e kishte pranuar me datën 14.07.2023, kjo për faktin se në shkresat e lëndës rezultojnë se urdhri përbarimor është lëshuar me datën 07.07.2023 dhe është dorëzuar në postë në të njëjtën datë. Në fletë kthesën postare nuk figurojnë data e marrjes nga marrësi por nënshkrimi i punonjësit të postës që i ka dorëzuar debitorit zarfën me shkresat e çështjes tregon datën 13.07.2023 të cilën gjykata e pranon si datë e dorëzimit të urdhrin përbarimor tek debitori. Gjykata vlerëson se borxhi i është shlyer para pranimit të urdhrin, rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 71 par.1 nenpar.1.2 të LPP dhe i referohet e kësaj dispozite, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që edhe sipas vlerësimit të gjykatës ankimore aktvendimi mbi përfundimin e procedurës në këtë çështje përbarimore është i rregullt dhe ligjor konform dispozitave nga neni 66 par.4 dhe nenit 71 par.1 nenpar.1.2 të LPP.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë sepse bazuar në shkresat e lëndës del se propozimi për përbarim është iniciuar me datën 06.07.2022, ndërsa debitorit i është dorëzuar në Postë me datë 07.08.2022. Është fakt se në fletë kthesën postare nuk figurojnë data e marrjes së dokumentit nga marrësi gjegjësisht debitori por nënshkrimi i punonjësit të postës që i ka dorëzuar debitorit zarfën përmban datën 13.07.2023 të cilën edhe gjykata e shkallës së dytë konsideron si datë të dorëzimit të urdhrin përbarimor dhe propozimit tek debitori.

Prandaj mbi këtë bazë vlerësimi juridik i gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë, e kjo sepse procedura përbarimore është iniciuar me datën 06.07.2022 përmes propozimit për përbarim, ndërsa debitori përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit e ka bërë me datën 08.07.2022, ndërsa propozimin për përbarim dhe urdhrin për përbarim debitori e ka pranuar me datën 13.07.2022, nga rrjedh se debitori e ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit para pranimit të propozimit dhe urdhrin përbarimor, e si rezultat i kësaj pretendimi i kreditorit se debitori ka detyrim përmbushjen e pagesës që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës nuk qëndron. Në këtë rast edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 71 par.1 nenpar.1.2 të LPP i cili parasheh që *“Dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarimor ose urdhri përbarimor është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, si dhe nenin 66

par.4 i cili parasheh qe “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbaremore*”, dhe se mbi këto rrethana edhe kjo gjykatë e pranon ne tërësi përfundimin juridik te gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkalles se dytë analizoi pretendimet e kreditorit se gjykata e shkalles e parë e ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike e gjithashtu edhe te drejtën materiale, por te njëjtat i vlerësoi si te pabazuara dhe paargumentuara ashtu qe i refuzoi si te tilla ndërsa aktvendimin shkalles se parë e vërtetoj.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS ,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.208/24, me datë 23.04.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi